



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS

KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

Dërgues: Instituti i Ndërtimit Nr. Prot/ 119/2, Data 03/02/22,
Shkurtimi i lëndës: Dërgim opinionance teknike

Për trajtim nga:	<u>Projektet</u>
(struktura të tjera të ngarkuara)	
Me porosi:	

Afati: Normal (7 ditë) Prioritet (3 ditë) Urgjent (Brenda ditës) Pa afat/për dijeni
Tjetër ditë

Data 10.02.22, Nr. Prot. 428/1

Nënshkrimi: (TITULLARI) [Signature]

Nr. fl. 20 (njëzet)

Marre në dorëzim: 10.2.22,

Nënshkrimi: [Signature]

Kalon për trajtim (struktura): BERD

Me porosinë: _____

Marre në dorëzim: _____, Nënshkrimi: _____

Kalon për trajtim (struktura): _____

Me porosinë: _____

Marre në dorëzim: _____, Nënshkrimi: _____

Kalon për trajtim Specialistit: _____

Me porosinë: _____

Trajtimi i materialit përfunduar më: _____ Specialisti

Trajtimi i materialit pranuar më: _____ Eprori në shkallë hierarkike

Trajtimi i materialit miratuar më: _____ Eprori në shkallë hierarkike






REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
INSTITUTI I NDËRTIMIT
DREJTORIA E RREGULLAVE TEKNIKE DHE OPOONENCAVE

Nr. 119/2 prot



Date 03/02 /2022



Lënda: **Dërgim Oponencë Teknike**

BASHKISË DURRËS

Lagjia Nr.1, Sheshi "Liria", Durrës

Në bazë të kërkesës suaj me Nr.428 Prot, datë 17.01.2022, protokolluar me tonën me Nr.119 Prot, datë.19.01.2022, "Kërkesë për kryerjen e Oponencës teknike", po ju dërgojmë në 2 kopje, oponencën teknike të projekt zbatimit të objektit: " **Rikonstrukcion i Qendrës Kulturore të Fëmijëve Durrës**", Bashkia Durrës.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Z. Artan SHKRELI



**OPONENCË TEKNIKE
PËR PROJEKTIN E ZBATIMIT TË OBJEKTIT
“RIKONSTRUKSIONI I QENDRËS KULTURORE TË
FËMIJËVE” , BASHKIA DURRËS**

POROSITËS: BASHKIA DURRËS

PROJEKTUES : SHOQËRIA “DEA STUDIO” SHPK

GRUPI I PROJEKTIMIT:

PROJEKTI ARKITEKTONIK

- | | |
|-----------------------|-----------------|
| - Ark.Ervin TACI | Nr.Lic.A.0210/2 |
| - Ark.Alket MESLANI | Nr.Lic.A.0791/2 |
| - Ark. Klodiana EMIRI | Nr.Lic.A.2006/1 |

PROJEKTI KONSTRUKTIV

- | | |
|-------------------------|------------------|
| Shoqëria: “GB-a-STUDIO” | Nr.Lic.N.4956/4 |
| - Ing.Gentjan LIPE | Nr.Lic. K.1308/1 |
| - Ing.Gerti CALLIKU | Nr.Lic. K.1801/1 |

PROJEKTI ELEKTRIK

- | | |
|-----------------------|-----------------|
| - Ing. Armand SHKEMBI | Nr. Lic. E.1144 |
|-----------------------|-----------------|


PROJEKT HIDROTEKNIK

- | | |
|------------------|------------------|
| - Ing.Mirel MICO | Nr. Lic.M.1238/1 |
|------------------|------------------|

PROJEKTI MEKANIK

- | | |
|------------------|------------------|
| - Ing.Mirel MICO | Nr. Lic.M.1238/1 |
|------------------|------------------|

Bëhet kjo oponencë teknike për projektin e zbatimit të objektit: “RIKONSTRUKSIONI I QENDRËS KULTURORE TË FËMIJËVE” , BASHKIA DURRËS, mbështetur në Ligjin Nr. 8402 dt.10/09/1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Neni 6; në V.K.M. Nr.1055 dt.22.12.2010 “Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”; në Urdhërin e Ministrit Nr.243 dt. 12.06.2019 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të marrëveshjes për kryerjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit” si dhe në Vendimin Nr.354, dt.11/05/2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projekte, mbikqyrje dhe kolaudim”.



Grupit të oponencës i janë vënë në dispozicion këto materiale:

- Kërkesa për kryerjen e Oponencës Teknike e Bashkisë Durrës me Nr.Prot 428, datë.17.01.2022, protokolluar me tonen me Nr. Prot.119, Datë 19.01.2022.
- Marrëveshja ndërmjet Institutit të Ndërtimit dhe Bashkisë Durrës me Nr. 119/1 prot, të IN-së, ku tarifa e kryerjes së oponencës teknike është **129,745** (njëqind e njetzet e nente mije e shtateqind e dyzet e pese) lekë me TVSH .
- Plan vendosja e struktures
- Projekti Konstruktiv + Relacioni Konstruktiv
- Projekti Arkitektonik + Relacioni Arkitektonik
- Projekti Elektrik + Relacioni elektrik + Panelet elektrike
- Projekt Hidroteknik + Relacion teknik
- Projekti I MNZ + Relacion teknik
- Projekti i instalimeve Ngruhje – Ventilimit + Relacion teknik
- Preventivi I punimeve
- Specifikime teknike
- CD

Materiali i dorëzuar do të konsiderohet i mirëqenë dhe i saktë nga ana ligjore, absolutisht në përgjegjësi të dorëzuesit, dhe do të shërbejë si bazë për vlerësimin e projektit dhe hartimin e Oponencës Teknike.


1. PROJEKTI ARKITEKTONIK

Pranë grupit të oponencës është venë në dispozicion projekt zbatimi për objektin: **“RIKONSTRUKSIONI I QENDRËS KULTURORE TË FËMIJËVE”**, Bashkia Durrës.

GJENDJA EKZISTUESE

Qendra Kulturore e Fëmijëve në Durrës ndodhet në rrugën “Egnatia” në krah të Bankës Kombëtare Tregtare. QKF është themeluar në vitin 1945. QKF ka nje kapacitet prej 600 fëmijësh si dhe koordinon e organizon veprimtarite kulturore, artistike, shkencore e sportive të rreth 60 shkollave 9-vjeçare të rrethit të Durrësit.

Godina ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 2000 m² dhe ambjentet që përmban qendra përfshijnë : sallë shfaqjesh me kapacitet 252 vende, 2 salla baleti, klasa pikturë, klasa me tematika të ndryshme, zyra për administratën si dhe ambjente të tjera ndihmëse. Ndërkohë, afro 370 m² hapësira janë të papërdorura për shkak të degradimit.



ZGJIDHJA FUNKSIONALE E PROPOZUAR

Së pari projekti rishikon organizimin funksional , pozicionimin dhe ndarjen e ambienteve në funksion të rritjes së funksionalitetit të organizimit planimetrik, rregullimin e akseseve dhe lëvizjen në vertikalisht. Qendrës kulturore i shtohet dhe hapësira rinore e cila pozicionohet në katin e poshtëm me hyrje të dedikuar. Shkalla merr rëndësinë që i takon si element i rëndësishëm në formulimin e interierit të objektit. Edhe shkalla tjetër që lidh katin përdhe me hapësirat rinore rikompozohet dhe hapet atriumi.

Projekti rregullon aksesimin për personat me aftësi të kufizuar me anë të rampës së vendosur në hyrje dhe lëvizjen në vertikalisht me anë të një ashensori platformë të vendosur tek shkalla kryesore duke përmbushur kriteret kombëtare dhe europiane për personat me aftësi të kufizuar.

Holli gjatësor që përshkon planimetrinë në katin përdhe do të trajtohet si një hapësirë ekspozicioni dhe do të shërbejë si element i prezantimit dhe njohjes së historikut, arritjeve dhe krenarisë së qendrës kulturore.

Projekti rishikon ndarjen ambienteve, klasave dhe shton hapësirat rekreative si hapësira të rëndësishme interaktiviteti, kreativiteti, argëtimi, qëndrimi etj. si për të rinjtë edhe për fëmijët. Salla e shfaqjeve plotësohet me ambiente ndihmëse si dhoma zhveshje, atelie skenografie, tualete të cilat vendosen në një volum që shtohet në tarracën e objektit.

Ndërtesa plotësohet me ambientet teknike të nevojshme, dhoma elektrike dhe dhoma mekanike, të cilat pozicionohen në katin përdhe. Tarraca e objektit do të mbulohet pjesërisht dhe do të trajtohet si një hapësirë verore për aktivitete të ndryshme.

Salla e shfaqjeve do të trajtohet me panele veshëse absorbuese për të rritur cilësinë akustike të saj. Do të projektohet ndricimi profesional i sallës. Mbulesa e sallës do të ribëhet për shkak të problemeve konstruktive dhe degradimit. Do të zëvendësohen ulëset plastike të sallës në mënyrë që të jetë një sallë dinjitoze. Do të hapet një dalje e dytë nga salla dhe do të jenë me dyer antipanik për të përmirësuar evakuimin e sallës në raste emergjence.

Do të zëvendësohen të gjitha dyert, dritare, veshje, risuvatime muresh, ritrajtimi i shtrimeve me karakteristika fiziko-mekanike dhe njëkohësisht zë-absorbuese. Do të realizohen tavane të varur kombinuar me sistemin e kondicionimit, ndricimit dhe absorbimit akustik.

Për sa i takon trajtimin arkitektonik të exteriorit të godinës , ndërhyrje përqëndrohen në volumin në pjesën veriore të objektit.

Fasada do të trajtohet me veshje etalbondi të perforuar dhe me ndricim nga pas duke i dhënë një karakter modern dhe duke e vënë theksin tek kontrasti dhe raporti që krijohet mes të vjetrës dhe të resë.

Muret e reja që do të ndërtohen në hapësirat e brendshme do të jenë sisteme knauf 15 ose 10 cm me dy pllaka diamant 2x12.5 mm në secilin anë me lesh guri në 100 ose 50 mm në brendësi .



Përvec tualeteve, ambjenteve teknike dhe sallave të baletit, në gjithë pjesën tjetër të objektit dyshemete do të shtrohen me gome Noraplan 3 mm.

Sa i takon llojit të dymit, janë përdorur 3 lloje të tilla. Vlen për tu përmendur një mekanizëm mjaft i nevojshëm i përdorur të disa nga dymet është ai i antipanik. Kjo përdoret të daljet e emergjencës dhe është kusht i rëndësishëm për daljen sa më të shpejtë të njerëzve në raste emergjence.

KONKLUZION

Në përfundim të projekt zbatimit të venë në dispozicion për: "RIKONSTRUKSIONI I QENDRËS KULTURORE TË FËMIJËVE", Bashkia Durrës, arrijmë në përfundimin se: në aspektin funksional, objekti i parashikuar për t'u rindërtuar, disponon zgjidhje të mirë, kompakte, duke respektuar standartet e vena në përdorim. Me hapësira dhe ambiente të cilat krijojnë kushte optimale për zhvillimin e aktivitetit. Projekti nga ana teknike për fazën e marrjes së lejes së ndërtimit është i plotë.

2. PROJEKTI KONSTRUKTIV

Struktura egzistuese, Qendra Kulturorë e Fëmijëve Durrës është një godinë ekzistuese me 2 dhe 3 kate mbi tokë, me konstruksion mbajtes murature tulle.

Sipas relacionit teknik arkitektonik Objekti ekzistues ndodhet në gjendje të degraduar dhe ka problem konstruktive që e kanë bërë të papërdorshme një pjesë të hapësirave e si pasojë ka nevojë të rikonstruktohet.

- Ndërtesa ka probleme me elementet konstruktive, soleta në një zonë është demtuar në disa pjesë, probleme të mbulesës së sallës së shfaqjeve, probleme të theksuara të lagështisë dhe prezencës së mykut dhe rifinitura të degraduara.

- Në anën jugore, pjesa e godinës që është ndërtuar në kohën e pushtimit fashist ka pësuar dëmtime fizike në tarracë dhe hidroizolim të saj që ka shkaktuar depërtimin në vite të lagështisë dhe dobësime të strukturës ekzistuese. Soleta e tarracës ka pësuar dëmtime të mëdha të riparueshme të cilat kërkojnë ribërjen e saj.

Ndërhyrjet që do të kryhen bazohet në dy aspekte kryesore :

- **Rigjenerimin fizik të ndërtesës**
- **Rigjenerimin arkitektonik të saj**

Qëllimi është për ta bërë qendrën kulturore të fëmijëve një hapësirë dinjitoze, mirëfunksionale që mund të shërbejë sa më mirë nxitjes së aktivitetit social-kulturor të fëmijëve të qytetit të Durrësit.

Objekti do të shpëtojë një rikonstruksion total si në pjesën e brendshme ashtu edhe në atë të jashtme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
INSTITUTI I NDËRTIMIT
 DREJTORIA E RREGULLAVE TEKNIKE DHE OPOONENCAVE

Nderhyrjet ndertimore konsistojnë:

- Per shkak te problemeve te theksuara konstruktive, soleta e pjeses se objektit te ndertuar ne periudhen e pushtimit italian do te prishet dhe rindertohet nga fillimi. Soleta do te jete 30 cm me traveta dhe mbushje me tulla me vrima.
- Te dyja shkallet e objektit do te prishen dhe rindertohen per shkak te riformulimit dhe rikompozimit te hapësirave. Shkallet do te realizohen me konstruksion metalik, bazamake druri 3 cm dhe parapet xhami te temperuar me lartesi 90 cm.
- Ambientet ne krah te salles se shfaqjeve (qe ndodhen siper fugatures se objektit qe ndan pjesen jugore te ndertuar ne periudhen e pushtimit austriak dhe ate te ndertuar ne periudhen e komunizmit) do te prishen per arsye konstruktive te mbeshtetjes se soletes dhe rindertohen duke zgjeruar ambientet siper tarraces. Kjo pjese do te mbulohet me konstruksion metalik qe mbeshtetet tek muri i salles se shfaqjeve nga njera ane dhe mbi koloncina metalike na anen tjeter duke u zgjatur per te mbuluar edhe nje pjese te tarraces qe do te perdoret per aktivitete te ndryshme.
- Mbulesa e salles se shfaqjeve do te ribehet gjithashtu. Do te mbulohet me konstruksion metalik. Do te shtohet lartesia e salles gjithashtu me konstruksion metalik.
- Do te cmontohen vetratat ne ambientet e brendshme (paretet ndarese te hapësirave te brendshme jane me mur deri ne gjysem lartesia dhe vetrata ne pjesen e siperme) dhe do te ngrihen muret deri ne lartesine perfundimtare te katit.
- Do te prishet dhe ribehet suvaja ne te gjitha pjeset qe ka probleme me lageshtine.

Për të realizuar oponencën teknike të projektit konstruktiv të objektit i janë vënë në dispozicion materialet teknike të mëposhtëme :

1. Projekti konstruktiv
2. Raporti teknik konstruktiv

Kushtet teknike dhe normativat

Relacioni teknik I paraqitur jep te dhena vetem per shtesat qe do te ndertohen me konstruksion metalik. Ne te nuk behet nje analize e hollesishme strukturore mbi gjendjen e godines ekzistuese.

Rekomandojme qe ne relacionin teknik te behet nje analize e hollesishme strukturore e gjendjes ekzistuese te godines , si dhe te theksohet qe nderhyrjet e propozuara ne kete objekt nuk prekin elementet struktural te objektit dhe nuk ndikojne ne qendrueshmerine e pergjithshme te objektit.

Për vlerësimin strukturorë, rregullat e përgjithshme, parimet e projektimit konceptual, veprimet në struktura dhe për hartimin e projektit strukturor jane perdorur Kushtet teknike Shqiptare KTP-N2-89 si dhe Eurokodet.



Materialet strukturale

Sipas relacionit teknike materialet qe do te perdoren jane : Beton I klases C25/30.
Celiki I klases S 500c $f_y = 500 \text{ N/mm}^2$. Celik struktural S275 JR dhe S235 JR (Struktura primare),

Bullonat e ankorimit do te jene Grade 4.8

Nga analizimi i *Relacionit Teknik*, që shoqëron projektin konstruktiv vërejmë se:

Shtesat qe do te realizohet jane konceptuar dhe llogaritur me konstruksion metalik te mbeshtetur me strukturen b/a te godines ekzistuese, por pa percaktuar tipin e struktures mbajtese te godines ekzistuese.

Ne relacion jepen te dhenat me te cilen jane projektuar shtesat si me poshte:

- Llogaritja e elementeve metalike eshte bere duke perdorur ETABS 2000, sipas Eurocode 3 – 2005.
- Konstruktori ka parqitur disa parametra sizmik te marre ne llogaritje , per truall te kategorise C dhe Intensitet Sizmik IX balle (MSK-64), ku parametrat jane $k_e = 0.42g$, Per truall te kategorise C dhe Spekter elastik te Tipit 1, jane perdorur parametrat e meposhtem: $a_g = 0.26g$; $S = 1.15$, $T_B = 0.2s$, $T_C = 0.6s$, $T_D = 2s$, por pa paraqitur nje studim te hollesishem sizmik per sheshin e ndertimit *Rekomandojme qe duhet te hartohet studimi i detajuar sizmik i trullit ku do te kryhet shtesa mbi objektin ekzistues.*
- Objekti eshte klasifikuar sipas rendesise (Class 2) ku Koefficienti i rendesise se objektit eshte $k_I = 1$.
- Faktori i sjelljes se struktures per duktilitet DCM dhe tipin e struktures eshte marre ne llogaritje $q = 4$.
- Ngarkesat e perhershme dhe te perkohshme te paraqitura per shtesen qe do te realizohet , jane marr konform kushteve teknike.
- Janë paraqitur kombinimet e ngarkesave që veprojnë në objekt. Kombinimet janë marrë konform normave të projektimit.

Pershkrimi i elementeve strukturore (shtesat)

Pjese e projektit te rikonstruksionit të Qendrës se Femijeve Durres jane:

- Mbulesa e salles se shfaqjeve
- Mbulesa e tarraces
- Shkallet

Projekti konstruktiv eshte hartuar nga shoqeria “Dea Studio” me Ing. Gerti Calliku, Ing. Valbona Calliku dhe Ing. Gentjan Lipe dhe eshte paraqitur ne 41 flete format A3. Shtesat e reja do te realizohet me strukture metalike.



Mbulesa e salles se shfaqjeve

Mbulesa e salles se shfaqjeve eshte strukture metalike e tipit portal. Ne te gjithe perimetrin ajo do te mbeshtetet ne traret ekzistues b/arme. Lidhja e struktures se re me ate ekzistuese do te behet nepermjet bullonave te ankorimit (UPA kimike).

Mbulesa eshte zhvilluar ne dy kuota te ndryshme me disnivel 1.1m per te siguruar hapesiren e duhur teknike ne zonen e skenes.

Struktura perbehet nga portale me trare IPE240 & IPE300 dhe kollona HEB200, te mbeshtetura ne nje tra HEB200 i cili do te mbeshtetet ne traret b/arme ekzistues. Arkarecet jane profile te formuar ne te ftohte, te zinkuar, me spesor 2 mm. Kontraventimet jane profile L70*7, te vendosur tek ose cift, konform forcave. Struktura eshte e kontraventuar ne te kater faqet e saj si dhe ne mbulesa dhe nyjet lidhese me objektin ekzistues jane konsideruar cerniera.

Mbulesa e tarraces

Mbulesa e taraces do te jete strukture metalike. Ajo do te mbeshtetet ne taracen e objektit. Lidhja e saj me strukturat ekzistuese do te behet nepermjet bullonerise se ankorimit. Ne mbulesa jane vendosur edhe 4 dritare (skylight) per te siguruar ndricim natyral. Kollonat jane CHS168.3*8. Traret primare jane IPE240 & IPE200.

Arkarecet jane profile te formuar ne te ftohte, te zinkuar, me spesor 2 mm. Kontraventimet jane profile tubolare me permasa e spesore te ndryshem (referoju fleteve te projektit).

Struktura eshte e kontraventuar vertikalisht dhe ne mbulesen e saj.

Shkallet

Shkallet do te jene me strukture metalike. Traret do te jene UPN220& UPN240 ndersa shkeljet llamarine spesor 5 mm e kthyer ne forme U dhe veshje me derrase. Lidhja e shkalleve me strukturat ekzistuese b/arme do te behet me UPA kimike. Kollonat mbajtese jane profil metalik te tipit SHS100*4 dhe do te mbeshteten ne plinta. Mungojne detajet e realizimit te plintave. Të plotësohen.

PËRFUNDIME REFERUAR KONSTRUKSIONIT

- Objekti (shatesat) jane projektuar me sistem konstruksioni metalik tip ramë e vendosur mbi konstruksion b/a (por pa percaktuar se mbi cilet element vendoset)
- Klasa e celikut e zgjedhur, parimisht është e përshtatshme për zonat me sizmicitet te larte. Permasat e prerjeve terthore te profileve metalike jane zgjedhur drejt.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
INSTITUTI I NDËRTIMIT
 DREJTORIA E RREGULLAVE TEKNIKE DHE OPONENCAVE

- Përpara ndërhyrjeve ne godinën ekzistuese rekomandojmë të behet nje analizë e thelluar strukturore mbi gjendjen ekzistuese të godinës dhe qëndrueshmërinë e saj konstruktive. Relacioni teknik duhet plotesohet dhe me analizën strukturore mbas ndërhyrjeve.
- Ne fletet e vizatimit te projektit konstruktiv duhet te vendosen me shume shenime teknike te nevojshme per realizimin e punimeve te zbatimit.
- Projekti duhet te plotesohet me detajet e lidhjeve te elementeve metalik me ato b/a.
- Mënyrat e ndërhyrjeve, armimi i secilit element në vecanti dhe përmasat e prerjeve tërthore të elementeve strukturore mbeten përgjegjesi e konstruktorit të objektit.

4. PROJEKTI HIDROSANITAR

Objekti: **“RIKONSTRUKSION I QENDRES KULTURORE SE FEMIJEVE” – DURRES**

Të përgjithshme

Oponenca teknike per projektin e zbatimit te objektit: **“Rikonstruksion i Qendres Kulturore së Fëmijëve Durrës”** është bërë duke u mbështetur në materialet e mëposhtëme të Projekt Zbatimit i cili permban:

- **Raportin teknik**
- **Vizatimet** e Projekt Zbatimit, të cilat do të japin grafikisht në menyre të detajuar të gjitha punimet që parashikohen të kryhen.
- **Preventiv Punimesh**

Materialet që jane vene ne dispozicion të Oponences janë si me poshte:

Materiale të shkruara :

Raporti Teknik(për projektin e instalimeve hidro-sanitare, si dhe mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi dhe Ngrohje -Ventilim) në format A4 1-47 (H/S ,H/Z dhe NG-V) faqe


Vizatimet e Projekt Zbatimit (Materialet grafike) format A3 1-9 H/S dhe 1- 3 H/Z dhe NG-V format A3 1-13 fletë

Projekti hidro-sanitar H/S , H/Z dhe HVAC është hartuar nga ing Mirel Mico me nr lic M 1238 .

RAPORTI TEKNIK

Ky raport përfshin :

- Sistemi i furnizimit me ujë(te ftohtë dhe të ngrohtë sanitar)
- Sistemi i shkarkimit të ujrave të zeza dhe të shiut dhe ventilimi



- Sistemi i hidrantit të zjarrit .
- Sistemi Ngrohje – Ftohje – Ventilim

- ❖ **Raporti Teknik** është në përgjithësi një pasqyrë të qartë të metodologjisë së llogaritjes si dhe aplikimit të sistemeve hidrosanitare dhe mekanike në godina , ne rastin konkret nje godine administrative kulturore . Konkretisht kemi të bëjmë me nje godine administrative kulturore me 1 kat nëntokë dhe 2 kate mbi tokë .

- ❖ **SISTEMI I FURNIZIMIT ME UJË DHE SHKARKIMEVE TË UJRAVE TË ZEZA DHE TE BARDHA**

Sistemi i furnizimit me ujë të objektit “**Rikonstruksion i Qendrës Kulturore së Fëmijëve – Durrës**” që përbëhet 1 kat nëntokë dhe 2 kat mbi tokë është paraqitur brënda godinës kryesisht me insatanimet brënda nyjeve sanitare si dhe lidhjen e tyre me rrjetin e furnizimit kryesor që vjen nga rezervuarët dhe poma e llogaritur për këtë sistem . Përsa i përket furnizimit me ujë të ngrohtë për paisjet sanitare është menduar vendosja e boilerëve elektrikë (në rasti konkret liliptut me $v= 12$ litra) Në Raport Teknik jepen metodologjia e llogaritjes dhe dimensionimit të të këtij sistemi si dhe karakteristika e plota teknike të paisjeve te tij . Ky projektet paraqitet me zera punimesh edhe ne preventiv.

Duke patur parasysh Raportin Teknik si dhe vizatimet grafike Oponenca veren se :

- Projektuesi paraqet projektin e furnizimit me ujë të ftohtë dhe të ngrohtë për gjithë objektin e Qendrës Kulturore jo vetëm brënda nyjeve sanitare por edhe skemat aksonometrike te gjurmes së tubacionit si dhe ambjentin teknik ku janë të vendosura rezervuarët dhe pompa e këtij suistemi . Skema dhe i gjithë rrjeti i tubacioneve të furnizimit me uje te ftohte dh ete ngrohte jepet e dimensionuar.
- Në Raportin Teknik është folur mbi rezervuarin e ujit sanitar i cili duhet të krjojë një autonomi prej 24 orësh , dhe në ambjentin teknik tregohet që janë gjithsej 25 m^3 nga ku 5-7 m^3 do të përdoren për ujë sanitar. Në vizatimet teknike të furnizimit me ujë , në raport teknike dhe në prevnetiv jepen karakteristikat teknike te paisjeve të sistemit hidro sanitar si rezervuarët zingato , pompa e furnizimit m euje të objektit , ena e zgjerimit etj për ujin sanitar është llogaritur poma me prurje $Q= 5.76 \text{ m}^3 / \text{orë}$ dhe $H= 50 \text{ m}$.
- Përsa i përket lidhjes me rrjetin e jashtëm , meqënëse objekti është egzistues dhe ka funksionuar si qëndër kulturore , ka dhe një pikë lidhje të furnizimit me ujë e cila shfrytëzohet edhe për këtë sistem të ri që projektohet.



Konkluzione :

Projekti i furnizimit me uje të objektit “Rikonstruksion i Qendrës Kulturore së Fëmijëve – Durrës” është zgjidhur teknikisht drejt në përputhje me normat dhe standartet që janë në fuqi në vendin tonë, si dhe normat dhe standartet europiane të projektimit.

❖ **SISTEMI I KANALIZIMIT**

Rrjeti i brëndëshëm dhe i jashtëm i kanalizimit të ujrave të zeza dhe të bardha të objektit .

Ne Raportin Teknik dhe ne Vizatimet Grafike te paraqitura nga projektuesi është dhënë planimetria e katit nëntokë si dhe nyjet sanitare të zmadhuara për cdo kat të objektit , shoqëruar këto me skemat përkatëse të rrjetit të kanalizimit të brëndshëm dhe të jashtëm të godinës . Rrjeti i kanalizimit është paraqitur si në planimetri brënda nyjeve sanitare ashtu edhe në katin -1 nën tavan me shtrirje horizontale të tij deri në daljet jashtë godinës me puseta betoni. Mbasi është përcaktuar skema bëhen llogaritjet dhe dimensionimet e tubacioneve me anë të formulave dhe tabelave përkatës dhe rezultatet pasqyrohen ne vizatimet grafike.Kollonat e shkarkimit perfundojnë ne tarracë me nje kapuc ajrimi dhe për gjatë gjithë kollones vihen pjesë pastrimi një kat po një kat jo.Kollona e shkarkimit shoqërohet me nje kollonë tjetër paralele që kryen ventilimin e pajisjeve sanitare dhe të vetë kollonës .Dimensioni i kësaj kollonë varet nga dimensionin dhe lartësia e kollonës së shkarkimit. Rrjeti i brëndëshëm lidhet me rrjetin e jashtëm të kanalizimit nepermjet pusetave beton arme te reja për objektin.

Duke patur parasysh Raportin Teknik si dhe Vizatimet grafike për këtë instalim Oponenca mendon se :

- Projekti i Rrjetit të kanalizimit të ujrave të zeza të objektit të Rikonstruksion i Qendrës Kulturore të Fëmijëve - Durrës është paraqitur në planimetri, si dhe me skemat e aksonometrike të kollonave të shkarkimeve i qartë dhe i saktë . Ky rrjet paraqitet i dimensionuar.
- Përsa i përket rrjetit të jashtëm të kanalizimit , meqënëse objekti është e gzistues dhe deri pak kohë përpara dhe funksional do të thotë që ka një rrjet tubacionesh dhe pusetash që funksionojnë , prandaj nuk paraqet problem shkarkimi i rrjetit të brëndshëm që bëhe i ri.
- Po kjo situatë është me rrejtin e ujrave të shiut për të cilin nuk ka projekt të ri të mirfilltë , por është në punë dhe do shfrytëzohet rrjeti egzistues për objektin .
- Përsa i përket shkarkimit të ambjentit teknik ku janë vendosur rezervuarët dhe pompat për të dyja sistemit , është projektuar që ujrat e tij të mblidhen në një kunetë me zgarrë dhe me pas të shkarkojë në rrjetin e jashtëm të kanalizimit të objektit në pusetën më të afërt.

Konkluzion :



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
INSTITUTI I NDËRTIMIT
 DREJTORIA E RREGULLAVE TEKNIKE DHE OPONENCAVE

Projekti i kanalizimit të ujrave të zeza (të brëndëshme dhe të jashtëme), të objektit Rikonstruksion i Qendrës Kulturore së Fëmijëve” në Durrës , është zgjidhur teknikisht drejt dhe në përputhje me kushtet teknike të projektimit , që janë në fuqi në vendin tonë, si dhe standarteve europiane të projektimit për këto sisteme.

❖ SISTEMI I MBROJTJES NGA ZJARRIT

Sistemi i mbrojtjes nga zjarri është hartuar nga inxh Mirel MICO cili është licensuar edhe si eksperte zjarr-fikës. Materiali është paraqitur i plotë me të gjitha pjesët e elementëve përbërës të Sistemit të Mbrojtjes nga Zjarri . Ky material është i shprehur si në Raport Teknik ashtu dhe Grafikisht .

Oponenca vëren se :

Duke u nisur nga "Rregullorja mbi masat mbrojtëse kundra zjarrit në projektimin e ndërtesave të cdo lloji " janë përcaktuar drejt :

- Vendodhja e këtij objekti dhe lidhja e këtij objekti me objektet për rreth si dhe rrugët e kalimit dhe afrimi sa më afër i automjeteve zjarrfikëse pranë tij , Bulevardi Egnatia është rruga kryesore për hytjen në objekt , një rrugë me gjërsine dhe kushtet e përshtatëshme për manovrat që kryen një makinë zjarrfiksi , për tu afruar pranë objektit në rast reziku. Rrugët e brëndëshme , të shfityëzueshme për aeakuimin e punonjësv eapo daljet evakuse , të gjitha këto janë pjesë të projekt Arkitektonik që ndikojnë dhe në mbrojtjen pasive të objektit.
- Qëndrueshmëria ndaj zjarrit nga ana konstruktive , sipërfaqja faktike dhe ajo e kërkuar , normat REI , klasifikimin e saj në lidhje me normat e mbrojtjes nga zjarri , duke u shoqëruar ky klasifikim dhe me vizatime grafike. Pjesë këto të projektit konstruktiv për MKZ-në dhe të mbrojtjes pasive gjithashtu.
- Shpërndarja e Fiksave të Zjarrit Portativ (të dorës) në bazë të normave të zjarrit (shoqëruar me fletë vizatimi).Klasifikimi i zjarrit në objekt në bazë të tipit të objektit , funksionit që kryen , apo materialeve q ëka brënda bën përzgjedhjen e tipit të bombulës shuarse. Nga projektuesi janë përcaktuar të përdoren shuars të Tipit EN3 pesha 6 kg , Klasa 34A 233BC dhe në ambjnetet elektrike apo servera të Tipit CO2 , Klasa 113B EN3. Përzgjedhja dhe vendosja e tyre nga projektuesi është bërë sipas normave dhe standarteve europiane të projektimit UNI 10779 që janë në fuqi dhe në vendin tonë . Ky sistem shuars shoqërohet me sinalistikën e duhur.
- Evakuimi i personave që mund të ndodhen në godinë në rast zjarri ,dhe për godinë të këtij tipi mjaft i rëndësishëm , shoqëruar ky me fletë vizatimi ku shihet qartë evakuimi i njerëzve , duke përdorur dhe sinalistikën përkatëse . Eshtë përcaktuar drejt nga projektuesi dhe paraqitur saktë grafikisht për të gjithë objektin . Skemat e evakuimit duhet të vendosen ne



cdo kat të objektit ,kryesisht pranë shkallëve apo daljeve evakuse , dh etë jene të qarta dhe të kuptueshme nga të gjithë.

- Sistemi i furnizimit me ujë i hidrantit të zjarrit i cili dhe ky është një sistem i rëndësishëm për godinat kulturore administrative (ku ka grumbullim njerzish në salla të mbyllura) i cili projektohet duke u bazuar jo vetem në projektin arkitektonik por edhe në kriteret minimale të dhëna nga rregullorja e PMNZSH-së.

Në pjesën hidraulike të projektit të MKZ janë paraqitur drejt dhe saktë:

- Rezerva e ujit për shuarjen e zjarrit, është projektuar për mbrojtjen e gjithë objektit dhe qëndron e pa prekshme në rezervuarët e vendosur në ambientin teknik që janë të përbashkëta për të dyja sistemet. Nga projektuesi është menduar që kjo rezervë të ruhet me galexhand elektrik rezerva e ujit e llogaritur për këtë objekt është me vëllim $V= 25 \text{ m}^3$. Nga ku 5-7 m^3 janë për ujin sanitar dhe 18 m^3 janë për MNZ.
- Sistemi i përdorur në objekt për të gjithë godinën është sistemi i shuarjes me kaseta hidranti UNI 45 (DN 50 mm) , pozicioni i të cilave është përcaktuar sipas normave dhe standartave europiane dhe atyre që janë në fuqi në vendin tonë .
- Skema e dhënë për këtë objekt është llogaritur saktë dhe rrjeti i tubacineve paraqitet i dimensionuar.
- Eshtë parashikuar një grup presioni uji për sistemin e MNZ . Ky grup presioni është parashikuar të jetë e tipit MEP në përputhje me EN 12825, për gjithë sistemin e MNZ ,duke dhënë dhe karakteristikat teknike , në vizatime, raport teknik dhe në preventiv. Karakteristikat teknike janë përkatësisht $q= 18 \text{ m}^3/\text{h}$ me $h= 56.7 \text{ m}$.
- Tubacionet e ujit, dhe dimensionet e tyre janë përcaktuar drejt dhe janë tubacione metalike prej celiku në përputhje me standartet që janë në fuqi dhe ato europiane për këto sisteme .
- Pajisjet e shuarjes së zjarrit(kasetat metalike) si dhe vendndodhja e tyre UNI 45 (DN 11/2) me $L= 20- 25 \text{ m}$ si dhe prurje $q =2 \text{ liter/sek}$ UNI 671-2 apo standarte të tjera të ngjashme me to , janë përcaktuar saktë për të gjithë objektin .

Konkluzion

Oponenca mendon se projekti për mbrojtjen nga zjarrit të objektit "Rikonstruksion i Qendrës Kulturore së Fëmijëve" Durrës është hartuar drejt dhe saktë në përputhje me normat dhe standartet europiane si dhe rregulloren e PMNZSH-së për hartimin dhe paraqitjen e këtyre projekteve dhe llogaritjen e këtyre sistemeve.



❖ **PROJEKTI I NGROHJE –FTOHJES DHEVENTILIMIT**

Ky projekt është hartuar nga ing mjedisor Mirel Mico me lic M 1238/1 . Projekti paraqitet ne format A3 1- 13 fletë vizatimi dhe me Relacion Teknik format A4 pjesë e Raportit të pergjithshëm

Projekti i ngrohjes se objektit “ **Rikonstrusion i Qendrës Kulturore së Fëmijëve** ”, në Durrës eshte projektuar i tipit ajër –ajër nëtë cilin ngarkesa termike mbahet nga sistemi i ajrit të freskët , dhe i tipit ajër – gaz në të cilin ngarkesat termike mbahen nga sistemi i njësive të brëndëshme VRV , ndërsa ajri i freskët sigurohet nëpërmjet sistemit të ajrit ROOFTOP


Impianti i kondicionimit është i përbëre nga këto sisteme :

1. Sistemi hidronik i cili në vetvete përbëhet nga sistemi i njësive të brëndëshme VRV, sistemi i grilave , rrjeti shpërndarës dhe nga centrali termik/frigoriferik (central i përbashkët)
2. Sistemi i ajrit i cili përbëhet nga sistemi i kanaleve të shpërndarjes së ajrit, sistemi i grilave, difuzorëve , centrali i ajrit dhe nga centrali frigoriferik / termik (si central i përbashkët)
3. Sistemi i mbledhjes së kondensës së fan-coilave .

Për hartimin e projektit projektuesi është mbështetur në kriteret dhe kushtet e projektimit të vendodhjes dhe dhe të tipit të godinës.

Në shqyrtim të materialeve të vëna në dispozicion oponenca vëren se:

- Projektuesi paraqet nje Raport të plotë Teknik me sistemet e kodicionimit të përdorura në këtë objekt që krijojnë konfortin e tij.
- Për objektin jepet metodologjia e përdorur për llogaritjen e humbjeve të nxehtësisë së objektit dhe nuk paraqiten llogaritjet analitike të tyre, megjithëse gjithë sistemi jepet i dimensionuar dhe me karakteristika teknike për paisjet që përcaktohen nga këto llogaritje .
- Janë paraqitur planimetritë për cdo kat të objektit me sistemin e kondicioimit ajër – gaz që përfshin ambjentet ndihmëse , zyrat , hollet , sallat e baletit , te koncerteve , ku sistemi VRV është i përbërë nga Fan-coil dhe ajri të freskët që sigurohet nga ROOF TOP , dhe system tubacionesh bakri. Ky sistem paraqitet i dimensionuar si në rrjetin e tubacioneve ashtu edhe në atë të paisjeve të brëndëshme që janë të tipit kasetë , të maskuara me tavane të varuar sipas arkitekturës , karakteristikat e të cilave jepen të plota dhe të qarta në vizatime dhe preventiv



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
INSTITUTI I NDËRTIMIT
 DREJTORIA E RREGULLAVE TEKNIKE DHE OPONENCAVE

- Gjithashtu është treguar pozicioni i paisjeve të jashtme në tarracën e objektit të cilat furnizojnë paisjet e brendshme , nëpërmjet sistemit të tubave të bakrit që ndahen sipas zonave dhe kateve të llogaritura nga projektuesi. Për gjithë objektin është një njësi VRF me karakteristikat $Q_f = 145 \text{ kw}$ dhe $Q_{ng} = 165 \text{ kw}$.Kë ky system është shoqëruar me skemat elektrike të funksionimit .
- Janë paraqitur me specifikime teknike të plota paisja e ajrit Rooftop që janë pjesë e sistemi ajër –gaz . për cdo ambjent të objektit që ka nevojë për ajër të pastër Shpërndarja e ajrit në këto ambjente bëhet me sistemin e kanaleve , nëpërmjet difuzorëve të ajrit dhe thithja nëpërmjet grilave të ajrit , dimensionet dhe prurjet e tyre jepen në vizatime .
- Sistemi i ajrit i tipit rooftop paisje kjo e vendosur në tarracën e objektit është llogaritur kryesisht për sallat e baletit dhe atë të koncerteve , kapaciteti I tij është $Q = 73 / 70 \text{ kw}$ me sasi ajri $v = 14100 \text{ m}^3/\text{orë}$ dhe rënie presioni $P = 50\text{-}100 \text{ Pa}$
- Sistemi mbedhjes së kondensatit me tubacion PPR paraqitet i dimensionuar në projekt , pjerrësia e tubacioneve është projektuar me 5 % , në rast të kundërt do të përdoret pompë për largimin e tyre që derdhet në rrjetin e ujrave të përdorura .
- Nga projektuesi është parashikuar dhe ventilimi i nyjeve sanitare pa ajrim , ky instalim paraqitet I dimensionuar dhe në vizatime.


Konkluzion:

Projekti i sistemit HVAC për objektin “Rikonstruksion i Qendrës Kulturore së Fëmijëve Durrës” është zgjidhur drejt dhe paraqitur saktë si teknikisht ashtu dhe grafiksht. Zgjidhja e dhënë nga projektuesi plotëson qëllimin e detyrës së projektimit për një komoditet dhe komformitet të ambjenteve të këtij objekti për publikun dhe fëmijët që do ta frenkuentojnë atë .

5. PROJEKTI ELEKTRIK


Per objektin: Rikonstruksioni i Qendres Kulturore te Femijeve
 Bashkia Durrës
 Projekti eshte realizuar nga Ing. El. Armand Shkemi.

Projekti elektrik permban:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
INSTITUTI I NDËRTIMIT
 DREJTORIA E RREGULLAVE TEKNIKE DHE OPONENCAVE

1. Sistemi fuqise kati -1
2. Sistemi fuqise katet: 0 dhe 1
3. Sistemi fuqise Regjia
4. Sistemi ndricimit emergjent kati -1
5. Sistemi ndricimit emergjent katet: 0,1
6. Sistemi ndricimit emergjent Regjia
7. Sistemi ndricimit kati -1
8. Sistemi ndricimit katet: 0,1
9. Sistemi ndricimit Regjia
10. Sistemi sinjalizimit kundra vjedhjes kati -1
11. Sistemi sinjalizimit kundra vjedhjes katet: 0 dhe 1
12. Sistemi sinjalizimit kundra vjedhjes Regjia
13. Sistemi evakuimit kati -1
14. Sistemi evakuimit katet: 0 dhe 1
15. Sistemi evakuimit Regjia
16. Sistemi alarmit te zjarrit kati -1
17. Sistemi alarmit te zjarrit katet: 0,1
18. Sistemi alarmit te zjarrit Regjia
19. Sistemi monitorimit kamerave kati -1
20. Sistemi monitorimit kamerave katet: 0,1
21. Sistemi monitorimit kamerave Regjia
22. Sistemi furnizimit mekanik kati -1
23. Sistemi furnizimit mekanik katet: 0 dhe 1
24. Sistemi furnizimit mekanik Regjia
25. Sistemi mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike
26. Diagrama e sistemit DATA
27. Diagrama e sistemit kundra vjedhjes
28. Diagrama e sistemit evakuimit
29. Diagrama e sistemit alarmit zjarrit
30. Diagrama e sistemit monitorimit kamerave
31. Rrjeti ndricimit te jashtem
32. Skema elektrke e panelit kati per dhe PE-01
33. Skema elektrke e panelit kati pare PE-02



Nga analiza e relacionit teknik kemi:

Godina permban klasa mesimdhenie, ambiente sportive, biblioteke si dhe nje salle multifunksionale.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
INSTITUTI I NDËRTIMIT
 DREJTORIA E RREGULLAVE TEKNIKE DHE OPONENCAVE

Furnizimi me energji elektrike do te behet nga rrjeti i OSSHEE nepermjet gabines elektrike te vendosur prane ambientit te qendres.

Per furnizimin me energji elektrike ne menyre sa me konstante te qendres eshte parashikuar dhe nje gjenerator i cili ne rast te mungeses se energjise elektrike nga rrjeti do te bej furnizimin me energji. Gjithashtu per sistemet e sigurise si Intrusion, CCTV, Alarmi i zjarrit eshte parashikuar qe te furnizohen me energji elektrike nepermjet UPS me qellim furnizimin me energji elektrike te pandërprere.

Fuqia e gjeneratorit eshte llogaritur te jete 40kVA dhe do te jete 90% i ngarkuar. Eshte llogaritur qe 50% e ndricimit te qendres te furnizohet me gjenerator nderkohe qe vetem nje pjese e paisjeve elektrike do te furnizohen me gjenerator.

Paneli Kryesor do te pozicionohet ne katin perdhe prane ambientit teknik. Ne kete panel do te behet Komutimi midis linjes se rrjetit dhe linjes se gjeneratorit. Ne te do te pozicionohet nje ATS (Automatic Transfer Switch) e cila do te realizoj kete komutim.

Percjellesat dhe Kabllot duhet te kene kerkesa te larta per tipin e izolimit, mbeshtjelljes, dhe percjellesve te specifikuar.

Ne projekt jane parashikuar:

- Rrjeti i shperndarjes se fuqise
- Rjeti i ndricimit normal dhe te emergjences
- Impianti i tokezimit
- Impianti rrefeprites
- Impianti i detektimit te zjarrit
- Sistemi i kamerave
- Sistemi sinjalizimit kundra vjedhjes

Sugjerorj te paraqiten:

- Rrjeti i tokezimit
- Rrjeti DATA

Sugjerorj të behet tokezimi i shtyllave te ndricimit te jashtem.

Mendoj qe projekti i dhene ploteson kushtet teknike duke marre ne konsiderate sugjerimet e bera.

6. SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimet teknike janë paraqitur në 151 fletë formati A4, hartuar nga shoqeria projektuese "Dea Studio" shpk.

Ato janë ndarë në kapituj si më poshtë:

1. TË PËRGJITHSHME




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
INSTITUTI I NDËRTIMIT
 DREJTORIA E RREGULLAVE TEKNIKE DHE OPONENCAVE

2. GËRMIMET
3. PUNIME MBUSHJE DHE MBULIMI
4. PUNIMET E SHTRESAVE
5. BETONET
6. PUNIME MURATURE
7. PUNIME TAVANI
8. PUNIME FASADE
9. PUNIME BOJATISJE
10. PUNIME HIDROIZOLIMI DHE TARACE
11. PUNIMET E ELEKTRIKUT
12. PUNIME DYER DHE DRITARE
13. PUNIME SISTEMIMI

Konkluzion:

- **Specifikimet teknike janë të plota.**



7. PREVENTIVI I PUNIMEVE

Preventivi për objektin: **“RIKONSTRUKSIONI I QENDRËS KULTURORE TË FËMIJËVE”**, BASHKIA DURRËS, është paraqitur në 7 fq A4, e firmosur dhe vulosur nga shoqëria projektuese « Dea STUDIO » shpk me Ark.Ervin Taci.

Nga shqyrtimi i këtij preventivi vërejmë se:

- Vlera plote e preventivit eshte ne vleren **127,997,278.8 Lekë me tvsh**
- Në vlerën e sipërpërmendur është përfshirë vlera e TVSH-së (20%) dhe vlera e Fondit rezervë 2% .

Konkluzion

- Në preventiv, numrat e analizave dhe çmimet respective për secilin zë punimesh në përgjithësi janë marrë në përputhje me VKM Nr.629, dt. 15.07.2015 në fuqi në vendin tonë, por ka dhe disa ndryshime si psh zerat me numer analize 2.326; 2.267/a; 2.266 etj.
- Per zerat qe ne preventiv jane shenuar An (analize) nuk jane paraqitur analizat teknike te cmimeve.




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
INSTITUTI I NDËRTIMIT
DREJTORIA E RREGULLAVE TEKNIKE DHE OPONENCAVE


PËRFUNDIM

Nga studimi i materialeve të vëna në dispozicion, për projektin e zbatimit të objektit: **“RIKONSTRUKSIONI I QENDRËS KULTURORE TË FËMIJËVE”** , BASHKIA DURRËS, me porosites Bashkinë Durrës, konkludohet se: *Projekti plotëson kushtet teknike të projektimit , konkluzionet e dhëna në këtë oponence teknike të plotësohen gjatë zbatimit të punimeve.*


GRUPI I OPONENCËS


Ark. Elbarina KOLA 

Ing. Hidrotek. Mamica SHEHI 

Ing. Elektrik. Myzejen MAJOLLARI 

SHEFE SEKTORIT TE OPONENCAVE

Ing. Mamica SHEHI 



DREJTORE DREJTORIE

Ing. Valbona PONDE

